



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.276/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË departamenti i përgjithshëm, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike të paditësit: Prishtine, të cilën e përfaqëson

sipas autorizimit me shkrim kundër të paditurit: nga Mitrovica, për rimbursim të dëmit, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë: 10.04.2018 bie këtë:

AKT GJYKIM

1. **OBLIGOHET** i padituri nga Mitrovica që brenda afatit 7 ditor t'ia paguajë paditëses në emër të rimbursimit të dëmit shumën prej 122 euro me kamatë sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm,
2. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja ka ngritur padi me datën 19.05.2016 me anë të së cilës ka kërkuar që në emër të rimbursimit të dëmit i padituri t'ia kompensoi shumën prej 122 euro për arsye se me datën 12.05.2012 i paditura ka shkaktuar aksident trafiku dhe se i njëjti ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit.

E autorizuar e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se mbetet në tërësi sipas padisë dhe kërkesëpadisë i propozoj gjykatës që të bene administrimin e provave ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se meqenëse me administrimin e provave u vërtetua baza juridike e padisë dhe kërkesëpadisë i propozojmë gjykatës që ta obligoj palën e paditur që ta rimbursoi dëmin e shkaktuar në shumën e cikut si në padi dhe atë me kamat ligjore nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive ashtu si e aplikojnë bankat e Republikës së Kosovës për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, meqenëse nuk kemi prova se është paguar taksa gjyqësore shpenzimet e procedurës nuk i kërkojmë.

I padituri në seancën e shqyrtimit kryesor mungoj, edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar. Me propozim të te autorizuarës së paditësit seanca është mbajtur në mungesë të te paditurit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor i administroi këto prova: dosja e dëmit nr. urdhertransferti i dt. 31.05.2012, ujdia jashtëgjyqësore e dt.31.05.2012, vendimi nga e dt. 18.05.2012, vendimi i komisionit për trajtimin e dëmeve e dt.18.05.2014, nesa dërguar të paditurit nga ana e dt. 16.05.2012, certifikata e

regjistrimit të automjetit për palën e dëmtuar, polisa e sigurimit për palën e dëmtuar e dt. se vlefshmërisë 08.11.2011 deri me 08.11.2012, akt vierësimit i dëmit e dt. 17.05.2012, procesverbal i mbi dëmtimin e automjetit e dt. 15.05.2012, paraqitja e dëmit nga i dëmtuari, raporti policor nr e dt. 12.05.2012, transferi i lëshuar nga i dt. 13.06.2012, fotografitë lidhur me dëmin material.

Pas analizimit dhe çmuarjes së provave të cekura një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe rezultatit të kësaj procedurës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 të LPK, gjykata vlerësoi se në mes të palëve procedurale nuk janë kontestuese këto fakte:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë pjesëmarrës dhe shkaktar i aksidentit të datës: 12.05.2012 me automjetin " " me nr. të targave " cili ka qenë i pa siguruar gjegjësisht sigurimi i ka skaduar në momentin e aksidentit, në të cilin aksidenti i padituri e ka goditur automjetin "VW me targa , pronë e z. nga Mitrovica, duke i shkaktuar dëme materiale, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr. dt. 12.05.2012, si dhe skicën e aksidentit. Po ashtu për gjykatën nuk është kontestues fakti se personi i tretë, i dëmtuar ka parashtruar pranë paditëses kërkesën për kompensim të dëmit.

Nuk është kontestues fakti se paditësi ka lidhë ujdë jashtëgjyqësorë me dt. 31.05.2012, me të dëmtuarin nga Mitrovica për kompensimin e dëmit në shumën prej 122 euro.

Raporti i policisë i datës 12.05.2012 vërteton faktin se automjeti i të paditurit ka qenë i pa siguruar në momentin e aksidentit.

Se personi i tretë z. nga Mitrovica i dëmtuar në këtë aksident është kompensuar në emër të shkaktimit të dëmit nga ana e paditëses, vërtetohet në bazë të urdhër transferit të datës 31.05.2012.

Nuk është kontestuese që personi i tretë ka qenë i dëmtuar pasi që kjo vërtetohet me raportin e aksidentit me nr. i dt. 12.05.2012, së bashku me skicën e aksidentit.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenin 18.1 dhe 18.4 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësi, pasi i padituri në momentin e aksidentit ka drejtuar automjetin e pa siguruar, ndërsa dëmin e shkaktuar e ka mbuluar cila ka të drejtën e regresit.

Gjykata, lidhur me shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 450 të LPK-së, bazuar edhe në shkaktimin e shpenzimeve me veprime të palëve si dhe suksesit të palëve në procedurë.

Me sa u tha më lartë e në bazë të nenit 143 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.276/2016 Datë: 10.04.2017

GJYQTARI
Naim Mehulli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat 7 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.